



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

2019:292262

**Numri i  
lëndës:**

Datë: 18.11.2021

Numri i dokumentit: 02452368

**P.1407/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtare ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurve F.N. dhe M.G., për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), F.N. dhe M.A., për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.2126-2/19, të datës 13.12.2019, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur më datë 27.10.2021, në prani të Prokurorit të Shtetit Ardian Emini dhe të pandehurve, ndërsa me dt. 28.10.2021 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datën 18.11.2021, përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

*I pandehuri F.N.*, nga i ati I., e ëma F., e gjinisë Z., i lindur me dt.... në Ferizaj, me vendbanim në Fshat të vjetër K. Ferizaj, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, i dënuar edhe më parë, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

*I pandehuri M.G.*, nga i ati Xh., e ëma K., e gjinisë F. i lindur me dt. ...., në ... K Ferizaj, me vendbanimin në Ferizaj rruga "...” pa nr, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike,

shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë për vepra penale të ndryshme, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

***I pandehuri F.N.***, nga i ati I., e ëma H., e gjinisë K., i lindur me dt.... në ... K Ferizaj, ku dhe tani jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, me profesion kamarier, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

***I pandehuri M.A.***, nga i ati N., e ëma N., e gjinisë Q., i lindur me dt.... në fshatin ...K. Ferizaj, ku dhe tani jeton, me numër personal, ... ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i tre fëmijëve, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, i dënuar më parë për vepra penale armë mbajtje pa leje dhe rrahje, ndaj tij nuk udhëhiqen procedura tjera penale.

## **JANË FAJTORË**

### **Të pandehurit: F.N. dhe M.G.,**

Sepse më datë 16.08.2019, në rrugën ... “ në Ferizaj, pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit G.G. në bashkëkryerje marrin pasurinë e tij me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë që i pandehuri M. fillimisht merr banesën me qira nga i dëmtuari për të banuar përkohësisht në te dhe gjatë kësaj kohe së bashku me të pandehurin F.N. nga banesa marrin një televizor të markës “LG” , ngjyrë të zezë në vlerë prej 3000 € dhe një studio të markës “Philips” me vlerë rreth 200 €, të cilat pastaj ia shesin F.N. dhe M.A.

**Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

### **I pandehuri F.N.**

Sepse me datë 16.08.2019, në rrugën ... “ në Ferizaj, blenë pasurinë për të cilën ka mundur ta dijë se është përfituar me kryerje të veprës penale, ashtu që pasi që takohet me M., i njëjti i ofron një studio të muzikës për ta blerë me çmim prej 30 €, dhe pasi arrin marrëveshje rreth pagesës ia paguan shumën e lartcekur dhe merr studion e muzikës të markës Philips” me ngjyrë të zezë , pronë e të dëmtuarit G.G..

**Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, pranimi, apo fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

**I pandehuri M.A.**

Sepse me datë 16.08.2019, në rrugën ... “ në Ferizaj, blenë pasurinë për të cilën ka mundur ta dijë se është përfituar me kryerje të veprës penale, ashtu që derisa ishte në kafiterin e tij, një fqinjë i propozon për të blerë një televizor të markës “LG” ngjyrë e zezë, nga një shok i tij dhe pasi që arrijnë marrëveshje rreth çmimit prej 100 €, djali i tij shkon tek të pandehurit F.N. dhe M.G. dhe e merr televizorin në banesën e të dëmtuarin G.G.

**Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, pranimi, apo fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

Andaj gjykata në bazë të neneve 4 , 7, 8, 17, 21, 31, 38, 39, 40, 43, 44, 69,70, dhe neneve 313 dhe 333 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neni 365, 453 dhe 463 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurit i :

**G J Y K O N**

**Të pandehurin e parë dhe të dytë,**

Me dënim me gjobë, secilin në shumë prej nga 200 € /dyqind euro/, si dhe secilin me dënim me burg në kohëzgjatje prej nga 4 /katër muajve, i cili dënim me burg konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurve u zëvendësohet secilit me dënim në gjobë në shumën prej nga 1000 € /njëmijë euro/, dënimet e shqiptuara me gjobë do ti paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se të pandehurit nuk i paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, të njëjtat dënime do të ju shëndrrohen në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

**Të pandehurin tretë,**

Me dënim me gjobë, në shumë prej 200 € /dyqind euro/, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 €uro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

### **Të pandehurin katërt,**

Me dënim me gjobë, në shumë prej 200 € /dyqind euro/, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 €uro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë në mënyrë solidarë shumë prej 40 € /dyzetë e euro/, në afatin prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Po ashtu obligohen të pandehurit që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajnë secili veç e veç shumë prej nga 30 € /tridhjetë euro/, po ashtu në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari G.H.G. nga Ferizaj, rruga “ ... “, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.2126-2/2019, të dt.13.12.2019, ka ngarkuar të pandehurit e parë dhe të dytë për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të pandehurin e tretë dhe të katërt për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par.2 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të pandehurit të shpallen fajtor dhe tu shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar për të pandehurit gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 27.10.2021, në të cilën shqyrtim fillestar: që të gjithë të pandehurit u deklaruan fajtor për veprat penale për të cilat i ngarkon aktakuza, dhe atë për të gjitha pikat e saj, e ndër të tjera i pandehuri Flamur ka shtuar se ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë dhe po premtoj shumë sinqerisht se më nuk do të përsërisë këso vepra penale apo të ngjashme, e di që kam gabuar rëndë kësaj here dhe herëve tjera dhe tani veç ju kam kthyer punës dhe jam duke punuar si punëtor në ndërtimtari dhe gjendjen ekonomike nuk e kam pasur të mirë por prej se kam filluar të punoj atë e kam përmirësuar dhe tani jam i fejuar dhe së shpejti do të krijoj familje. Ndërsa i pandehuri Mensur ka deklaruar se ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, dhe shumë sinqerisht premtoj se nuk do të përsëris kurrfarë lloji të veprave penale, e di që gjer më tani nuk kam qenë në rrugë të drejtë dhe tani e kam kuptuar se kam gabuar dhe lus gjykatën që me rastin e shqiptimit të dënimit të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur. I pandehuri F. ka deklaruar se ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, nuk kam dashur të më ndodh ky problem, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, dhe më ka ardhur shumë keq që më ka ndodh ky rast dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris këso lloj vepra penale apo vepra tjera pasi unë punoj dhe nuk merrem me vepra të kundërligjshme. Kurse i pandehuri M. ka theksuar se ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, dhe në të ardhmen premtoj shumë sinqerisht se më nuk do të ndodh të kryej vepra të tilla apo të ngjashme pasi jam njeri familjar dhe kam biznesin tim dhe nuk jam njeri që merrem me veprime të kundërligjshme, por ky rast më ka ndodhur rastësisht dhe lus gjykatën që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysht këtë që e thash.

Gjykata lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohen, në bazë të nenit 248, paragrafi 2 të KPPRK-së, mori mendimin e prokurorit të shtetit, i cili deklaroi: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare dhe përputhet me dispozitat e nenit 248 të KPPRK-së, në mbështetje të provave dhe fakteve që i përmban aktakuza, i propozoj gjykatës

që të bëj pranimin e fajësisë së të pandehurve dhe të njëjtit ti shpall fajtor dhe tu shqiptoj një sanksion të paraparë me ligj.

Pasi që të pandehurit kanë pranuar fajësinë, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë së tyre, shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248, par. 1, të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoj se të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimin e kanë bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe provat materiale të çështjes penale konkrete dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit siç janë: Raporti i oficerit 2019-CF-1594 i dt.30.08.2019, deklarata e të dëmtuarit e dhënë në polici me dt. 30.08.2019, dy vërtetime mbi sekuestrimin e sendeve të dt.03.09.2019, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara i dt. 04.09.2019, deklarata e të pandehurit M.A. e dt. 03.09.2019, deklarata e të pandehurit F.N. e dt. 03.09.2019, deklarata e të pandehurit F.N. e dt. 11.09.20219, deklarata e të pandehurit M.G. e dt.05.09.2019, fotot dhe shkresat tjera të lëndës .

Meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 248, paragrafi 4, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. *( nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të dy të pandehurve të parë ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të bashkëkryerjes së veprës penale vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin e tretë dhe të katërt të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par.2 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitive të këtij aktgjykimi, në të cilin janë përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprave penale, për çka dhe të pandehurit u shpallën fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se të pandehurit kanë bërë pranimin e fajësisë, duke e shprehur pendimin e sinqertë për veprat penale të kryera, se kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisin kryerjen e veprave penale, ndërsa për të pandehurin e tretë dhe të katërt gjykata si rrethanë lehtësuese morri dhe ata e se më parë nuk kanë ra ndesh me ligjin, ndërsa gjykata për të pandehurin e parë dhe të dytë, si rrethana rënduese gjeti se të njëjtit edhe më parë kanë qenë të dënuar për vepra penale të ndryshme me aktgjykime të plotfuqishme, i pandehuri i parë për vepër penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, ka qenë i dënuar me aktgjykime të plotfuqishme P.nr 786/18 dhe për veprën penale vjedhje P.nr. 1182, për rastin e parë me dënim me gjobë kurse për rastin e dytë me dënim me kusht dhe me gjobë, ndërsa i pandehuri i dytë për vepra penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve ka qenë i dënuar me aktgjykim të plotfuqishme PKR.nr 171/19, me dënim me gjobë, për vepër penale Vrasje në tentativë me aktgjykim të plotfuqishme PKR.nr 171/19, me dënim me burg prej tri viteve dhe për vepër penale vjedhje me aktgjykim të plotfuqishme P.nr.1114/19, me dënim me kusht, si dhe për të gjithë të pandehurit vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale të kryera nga të pandehurit.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se që të katër të pandehurit kanë bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethana të kryerjes, rrezikshmërisë së saj dhe autorëve të tyre, që do të shërbej në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,**  
**DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**  
**P.1407/19, e datës 18.11.2021**

**Zyrtare Ligjore**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

**Kimete Bytyqi**

**Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.